



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 153

Tiranë – E hënë, 24 gusht 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 94/2020, datë 23.7.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 27, datë 1.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.....	9697
Ligj nr. 95/2020, datë 23.7.2020	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 29, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19’, të ndryshuar”.....	9697
Ligj nr. 97/2020, datë 23.7.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar.....	9697
Ligj nr. 115/2020, datë 30.7.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	9700
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 12, datë 21.7.2020	Për përcaktimin e numrit të faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas, rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës, si dhe rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës për pajisjen me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.....	9701
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 29, datë 28.7.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 28, datë 31.12.2012, të ministrit të Financave “Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’, të ndryshuar”.....	9702
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 28.7.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 29, datë 31.12.2012, të ministrit të Financave “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare”.....	9709

	Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).....	9717
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3516/4, datë 18.8.2020	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ruga Lidhëse e Apollonisë”.....	9721



LIGJ
Nr. 94/2020

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 27, DATË
1.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 9936, DATË 26.6.2008, ‘PËR
MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 27, datë 1.7.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratur në datën 23.7.2020

LIGJ
Nr. 95/2020

**PËR MIRATIMIN E AKTIT
NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 29, DATË 15.7.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHTESË NË
AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 15.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR
MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA
ADMINISTRATIVE GJATË
KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 29, datë 15.7.2020, “Për një shtesë në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19’, të ndryshuar”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratur në datën 23.7.2020

LIGJ
Nr. 97/2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9357, DATË 17.3.2005,
“PËR STATUSIN E PUNONJËSIT TË
SHËRBIMIT INFORMATIV TË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 2 e nenit 3 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
1. Në fund të shkronjës “b” shtohen fjalët “brenda dhe jashtë vendit”.



2. Në shkronjën “P” fjalët “i Shërbimit Informativ Ushtarak” zëvendësohen me fjalët “në strukturat e inteligjencës së mbrojtjes”.

3. Pas shkronjës “P”, shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) koha si punonjës në struktura të veçanta në SHISH. Procedura për njohjen e vjetërsisë në punë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Në pikën 4, të nenit 5, fjalët “botohet në dy gazeta kombëtare me tirazh të madh” zëvendësohen me fjalët “publikohet në faqen zyrtare të SHISH-it”.

Neni 4

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Kursi bazë

1. Në Shërbimin Informativ të Shtetit organizohet kursi bazë për formimin profesional të punonjësve.

2. Shtetasi, i cili pranohet në Shërbimin Informativ të Shtetit për t’u trajnuar në kursin bazë, ndërpret marrëdhëniet me Shërbimin nëse gjatë periudhës së trajnimit vlerësohet se nuk ka aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave.

3. Marrëdhëniet ndërpriten me urdhër të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit pas propozimit të drejtorit të njësisë përgjegjëse për zhvillimin e kursit bazë apo të njësisë së ngarkuar me shqyrtimin e rastit.

4. Kursanti që nuk paraqitet në detyrë pas emërimit dhe bën kërkesë për lirim nga Shërbimi pa shkaqe të justifikuara, brenda periudhës së provës, paguan të plotë pagën dhe shpenzimet e bëra për trajnimin e tij. Mënyra e përlogaritjes së shpenzimeve përcaktohet me urdhër të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.”.

Neni 5

Në nenin 7, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet: “Emërimi dhe periudha e provës”.

2. Në fillim të pikës 1, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Emërimi në detyrë është momenti i fillimit të marrëdhënies së punës për punonjës të SHISH-it”.

3. Në fjalinë e fundit të pikës 1, pas fjalëve “periudhës së provës”, shtohen fjalët “si dhe trajtimi financiar i mentorit”.

4. Në fund të pikës 1, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Trajtimi financiar i mentorit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

5. Në pikën 2, fjalët “e eprorit direkt” zëvendësohen me fjalët “e njësisë strukturore përkatëse”.

6. Në shkronjën “c”, të pikës 2, pas fjalës “kur”, shtohen fjalët “sipas procedurave përkatëse” dhe fjalia “Paaftësia duhet të konfirmohet nga njësi e ngarkuar me funksionet e inspektimit” shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës , shtohet fjalia “Vlerësimi i punës bëhet edhe me kërkesën e punonjësit.”.

2. Në pikën 2, fjalët “të cilësisë dhe shpejtësisë” shfuqizohen.

Neni 7

Në fund të pikës 1, të nenit 10, shtohen fjalët “për nivelin e lartë drejtues dhe “mirë” ose “shumë mirë” për nivelet e tjera.”.

Neni 8

Në nenin 11, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “punonjësit”, shtohen fjalët “jashtë vendbanimit” dhe në fund të fjalisë shtohen fjalët “për një periudhë deri në tre vjet”.

2. Pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Punonjësi, i cili transferohet jashtë vendbanimit, përfiton:

a) rimbursimin e plotë të shpenzimeve të transferimit të tij dhe/ose të familjes;

b) kompensimin për qira banese të akomodimit të tij dhe/ose të familjes, kur ai ose ndonjë pjesëtar i familjes nuk ka banesë në pronësi në vendin e ri të punës; ose

c) kompensimin për udhëtim.



Emërimi jashtë vendbanimit do të konsiderohet transferim për efekt të kësaj pike.

Masa dhe mënyrat e kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 9

Në nenin 12, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë:

“a) për një periudhë nga 3 (tre) deri në 9 (nëntë) muaj në vit për mbarëvajtjen e punës, për përfundimin e procesit të një çështjeje të veçantë ose në raste të mbingarkesës së krijuar në një njësi strukturore”.

2. Shkronja “b” shfuqizohet.

Neni 10

Në fund të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 13, shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Në rastet e trajnimit afatgjatë nga Shërbimi për një periudhë mbi gjashtë muaj, brenda dhe jashtë vendit, punonjësi është i detyruar të qëndrojë në SHISH 2 (dy) vjet pas kryerjes, në të kundërt kthen pagën dhe shpenzimet e trajnimit. Mënyra e përlllogaritjes së shpenzimeve përcaktohet me urdhër të drejtorit të SHISH-it.”.

Neni 11

Pika 5, e nenit 23, shfuqizohet.

Neni 12

Në fund të pikës 1, të nenit 29, shtohet fjalia “Shpërblimi përballohet nga fondi i veçantë i krijuar nga ana e Shërbimit Informativ të Shtetit.”.

Neni 13

Neni 35, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Mbrojtja e veçantë ligjore

1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit ose individ që merr pjesë në operacione të fshehta të këtij Shërbimi, mund të përdorë identitet të

dyfishtë në mënyrë të përkohshme, me qëllim garantimin e sigurisë së operacionit.

2. Procedurat për pajisjen, mbajtjen dhe përdorimin e identitetit të dyfishtë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

3. Kur individit ose punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, që merr pjesë në operacione të fshehta dhe përdor identitet të dyfishtë, për shkak të detyrës ose bashkëpunimit i kërcënohet jeta, shëndeti, familja apo prona, i garantohet mbrojtje e veçantë ligjore me urdhër të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.”.

Neni 14

Në fund të nenit 39, shtohen fjalët “bazuar në marrëveshjen ndërmjet titullarëve”.

Neni 15

Në nenin 45, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) përmbush kriteret për pension të parakohshëm dhe kërkon të largohet nga ky Shërbim;”.

2. Në shkronjën “dh”, fjalët “të mbështetura edhe nga njësia e ngarkuar me funksionet e inspektimit” hiqen.

3. Pas shkronjës “e”, shtohen shkronjat “f” dhe “g”, me këtë përmbajtje:

“f) cenohet kushti i sigurisë;

g) mosparaqitja në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për 7 (shtatë) ditë pune.”.

Neni 16

Në nenin 50 fjalët “10 ditë” zëvendësohen me fjalët “5 ditë”.

Neni 17

Në nenin 54, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1, shtohen fjalët “dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga Shërbimi.”.

2. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Punonjësi i SHISH-it, në rastet kur ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga



Shërbimi, ka të drejtë të ankohe pranë Komisionit të Disiplinës, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.”.

Neni 18

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të dispozitave të ndryshuara, përkatësisht të nenit 4, shkronja “g”, nenit 7, pika 1, dhe nenit 11, pika 3.

2. Ngarkohen drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit dhe ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 35, pika 2, të ndryshuar me këtë ligj.

3. Ngarkohet drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, pika 4, nenit 13, pika 1, germa “e”, dhe nenit 35, pika 3, të ndryshuar me këtë ligj.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 23.7.2020

LIGJ Nr. 115/2020

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8417, DATË 21.10.1998, “KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 83, pika 1, dhe 177, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 64, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 64

1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar.

2. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragu kombëtar.

3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumëmemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragu kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t’i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumëmemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.”.

Neni 2

Pika 1, e nenit 68, ndryshohet si më poshtë:

“1. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 30.7.2020

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 12, datë 21.7.2020****PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
FAQEVE PËR TË CILAT INFORMACIONI
PËRFITOHEM FALAS, RASTET E
PËRJASHTIMIT NGA PAGESA E
TARIFËS, SI DHE RREGULLA PËR
MËNYRËN E KRYERJES SË PAGESËS
PËR PAJISJEN ME INFORMACION QË
PRODHOHET OSE MBAHET NGA
AUTORITETET PUBLIKE**

Në mbështetje, të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13 dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

1. Personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, e përfitojnë informacionin dhe/ ose dokumentacionin pa pagesë deri në 20 fletë, për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër, pas vërtetimit të statusit përkatës.

2. Subjektet përfituese janë:

a) personat, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;

b) viktimat e dhunës në familje;

c) viktima të abuzuar seksualisht dhe viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;

d) viktima të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;

e) fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

f) fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

g) personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;

h) personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;

i) personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;

j) personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;

k) personat, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

l) personat, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

m) personat që provojnë se kanë të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet, që do të thotë nëse të ardhurat e tyre janë më të ulëta se niveli i pagesë minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Pas marrjes së kërkesës për informim nga subjekti kërkues, autoriteti publik, llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuesin.

4. Riprodhimi i dokumenteve të kërkuara do të bëhet nga drejtoria/sektori përkatës, me mjetet e riprodhimit që disponon autoriteti publik.

5. Subjekti kërkues bën pagesën e tarifës së përcaktuar nga autoriteti publik, për llogarit të autoritetit publik, pranë një banke të nivelit të dytë. Një kopje të mandatit të pagesës, subjekti kërkues ia bashkëlidh kërkesës, drejtuar autoritetit përkatës.

6. Me pagesën e tarifës përkatëse dhe paraqitjen e mandatit bankar, pranë autoritetit publik, dokumentet e kërkuara nga kërkuesi i dërgohen me postë ose i dorëzohen menjëherë të interesuarit.

7. Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij udhëzimi, subjektet për të cilat marrja e shërbimit, përcaktohet me ligj që të jetë pa pagesë.

8. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, autoritetet publike, që kanë detyrimin për dhënien e informacionit të kërkuar nga kërkuesi.



Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM
Nr. 29, datë 28.7.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 28, DATË
31.12.2012, TË MINISTRIT TË
FINANCAVE “PËR METODAT DHE
PROCEDURAT E RAPORTIMIT DHE
MARRJES SË MASAVE PARANDALUESE
NGA SUBJEKTET E LIGJIT NR. 9917,
DATË 19.5.2008 “PËR PARANDALIMIN E
PASTRIMIT TË PARAVE DHE
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 28, pika 3, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 28, datë 31.12.2012, të ministrit të Financave “Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Në nenin 1 bëhen ndryshime dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pas shkronjës “k”, shtohen shkronjat “j”, “l”.

Në nenin 3 bëhen ndryshime dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2, në fjalinë e parë, pas fjalëve “fotokopje të noterizuara” shtohen fjalët “ose dokument elektronik që plotëson kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi për

dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik”.

2. Në pikën 2, germa “a”, shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

Dokument identifikimi, i njohur me marrëveshje ndërkombëtare, brenda afatit të vlefshmërisë.

3. Në pikën 3, germa “a” shprehja “Libreza apo kontratë pune” zëvendësohet me “Libreza/kontrata pune, vërtetim pune apo dokument tjetër që provon marrëdhënie pune”.

4. Pika 4 zëvendësohet me këtë përmbajtje, “Për organizimet ligjore: identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit që ushtron kontroll faktik mbi to, sipas të dhënave të parashikuara në shkronjat e mësipërme, në varësi të faktit nëse është person fizik ose person juridik privat”.

Në nenin 4 bëhen ndryshime dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “Të hartojnë” shtohen fjalët “të përditësojnë dhe”.

Në nenin 5 bëhen ndryshime dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Prapa fjalës “teknologji”, shtohet fjalët: “ekzistuese dhe”.

Në nenin 6 bëhen ndryshime dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 fjalët, “të gjitha kategoritë e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende që nuk zbatojnë ose që zbatojnë pjesërisht standardet përkatëse ndërkombëtare, për të parandaluar e luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit” zëvendësohen me “me të gjitha kategoritë e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende për të cilat kërkohet marrja e masave të posaçme, sipas përcaktimeve apo kërkesave të autoritetit përgjegjës apo për klientë për të cilët kërkohet kjo masë.”.

2. Në pikën 3, germa “a”, pas fjalëve “marrëdhënie bankare” shtohen fjalët “ose financiare”;

3. Në pikën 3, germa “b”, pas fjalëve “në mënyrë që” fjalët “të sigurohen se bankat e huaja korrespondente” zëvendësohet me fjalët “të krijojnë bindjen se bankat ose institucionet financiare të huaja korrespondente”.



4. Në pikën 3, germa “e”, fjalia e dytë, pas fjalës “banka” shtohet shprehja “ose institucionet financiare të huaja”.

5. Në pikën 3, germa “P”, fjalët “bankave korrespondente” zëvendësohet me “institucioneve financiare korrespondente”.

6. Në pikën 3, germa “P”, nënndarja e fundit, fjalët “dokumentet e identifikimit të klientit” zëvendësohet me “informacionin dhe dokumentacionin përkatës që rrjedh nga masat e vigjilencës së duhur, nëse kërkohet”.

Neni 10 ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Subjektet, veprimtaritë e të cilëve përfshijnë transferta parash ose vlerash, duhet të sigurohen që transfertat ndërkufitare elektronike të jenë të shoqëruara gjithnjë me të dhëna si më poshtë:

a) Informacion i kërkuar dhe i saktë për dërguesin:

i. emrin dhe mbiemrin e dërguesit kur është individ;

ii. emërtimin, kur dërguesi është person juridik;

iii. numrin e llogarisë së dërguesit kur një llogari e tillë përdoret për të përpunuar transaksionin ose, në mungesë të një llogarie, një numër unik të referencës së transaksionit që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit;

iv. adresën e dërguesit ose numrin e identitetit kombëtar, ose numrin e identifikimit të klientit ose datën dhe vendin e lindjes.

b) Informacioni i kërkuar për përfituesin:

i. emrin dhe mbiemrin e përfituesit;

ii. emërtimin, kur përfituesi është person juridik;

iii. numrin e llogarisë së përfituesit kur një llogari e tillë përdoret për të përpunuar transaksionin ose, në mungesë të një llogarie, një numër unik të referencës së transaksionit që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit.

2. Subjektet marrin masat e tjera sipas parashikimeve të nenit 10, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

Në nenin 11 bëhen ndryshime dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2, fjalët “të cilit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion” hiqen.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“Formulari (RAD) duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, që mbështet

dyshimet e parashtruara në raport, si dhe lejon nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse, si: analizën e kryer, nxjerrjen e llogarisë bankare, dokumentet e identifikimit, të dhënat e transfertave, kontratat etj., dhe dërgohet i plotë në rrugë elektronike, si dhe me shkresë zyrtare nëse raportimi elektronik është objektivisht i pamundur.

Raportimi në rrugë elektronike, kryhet bazuar standardet, formatin dhe aksesin që autoriteti përgjegjës u siguron sipas kërkesës së bërë për këtë qëllim nga subjekti.”

Në nenin 12 bëhen ndryshime dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen me organet apo ndërmarrjet publike.”;

2. Pika 3, fjalia e parë riformulohet si vijon: “Raportimi nga subjektet i transaksioneve sipas këtij neni kryhet në rrugë elektronike sipas standardeve dhe formatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës.”.

Në nenin 15 bëhen ndryshime si më poshtë vijon:

1. Pika 1, gjerat “a” dhe “b”, ndryshohen si vijon:

Për zbatimin e këtij udhëzimi dhe anekseve si pjesë organike të tij:

a) aneksi I “Raporti për aktivitetin e dyshimtë” (RAD);

b) aneksi II “Raporti i transaksioneve të parasë fizike” (RTPF).

2. Në pikën 3, shprehja: “të cilat mund të pësojnë ndryshime në përputhje me legjislacionin në fuqi” hiqet dhe shtohet fjali me përmbajtje si më poshtë:

“Nëse është e nevojshme në funksion të administrimit të dhënave, njëtrajtshmërisë së raportimit për lloj subjektesh, ndërlidhjes me baza të tjera të dhënash, autoriteti përgjegjës mund të shtojë, pakësojë apo ndryshojë fusha të veçanta të anekseve pjese e këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj



ANEKS I
RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD)

1. Zgjidhni kutinë me kombinime:	
☐ Pastrim parash;	☐ Financim i terrorizmit; ☐ Fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale;
2. Zgjidhni kutinë me kombinime:	
☐ Raport i ri;	☐ Përmirëson një raport të mëparshëm; ☐ Transferte në Tentativë
PJESA I. INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË:	
1. Statusi ligjor i personit: a. ☐ Indiv; b. ☐ Person fizik tregtar; c. ☐ Person juridik; d. ☐ Shoqëri Anonime; e. ☐ Ent Publik; f. ☐ OJF; g. ☐ Organizime Ligjore h. ☐ SHPK (Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar) i. ☐ Kujdestar; j. ☐ Dege e shoqërisë se huaj; 2. a) Emri: _____ b. Atësia: _____ c. Mbiemri: _____ 3. Datëlindja/data e regjistrimit: _____ 4. Shtetësia: a. ☐ Shqiptar b. ☐ I huaj; 5. Vendlindja: _____ 6. Vendbanimin e përkohshëm (nëse ka): _____ 7. Gjinia: : a. ☐ Mashkull; b. ☐ Femër; 8. Dokumenti i identifikimit: a) ☐ Letërnjoftim; b) ☐ Pasaportë; c) ☐ Nr. Personal(NID); 9. Numri i dokumentit: _____ 10. Autoriteti lëshues: _____ 11. Emërtimi i Subjektit: _____; 12. NUIS/NIPT: _____; 13. Adresa e themelimit: _____; 14. Adresa e përkohshme (nëse ka): _____; 15. Punësim/lloji i aktivitetit: _____; 16. Nëse është PEP : ☐	
PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRE	
Shto	
PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER	
1. Numri i transaksioneve: _____; 2. Numri i llogarisë/ve: _____; 3. Data e kryerjes së transaksionit _____; 4. Monedha: Lek ☐ Euro ☐ USD ☐ GBP ☐ JPY ☐ CHF ☐ CAD ☐ Sipas një liste 5. Shuma e transaksionit: _____;	
PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË:	
a. Shpjegime/përshkrime të aktivitetit të dyshimtë : 500 Karaktere <b style="color: red;">Shënim: me help Të strukturohet në disa pika: 1. Përshkrimi i profilin të subjektit të RAD; 2. Analiza totale e rastiit duke përfshirë dhe analizë të historikut të transaksioneve; 3. Anomalitë e vërejtura në transaksion, veprime apo veprimtari të dyshimta; 4. Dyshimet për rastin; 5. Lidhje me raste të tjera të raportuara të dyshimta, nëse ka; 6. Nëse kërkohen udhëzime nga DPPPP; 7. Te dhëna apo informacione të tjera me interes.	
PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE: 10.MB ZIP	
PJESA VI. INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES:	
Emri: _____;	Data e raportimit: _____;
Personi përgjegjës: _____;	Tel. _____;
Firma: _____;	E-mail. _____;
Aprovuesi: _____;	Adresa: _____;



INSTRUKSIONE
PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT
“RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË”
RAD

HYRJE

“Raporti i aktivitetit të dyshimtë” (RAD) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë. Ky formular plotësohet nga subjektet, për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

1. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse aktiviteti dyshohet se ka të bëjë me pastrim parash, financim të terrorizmit apo fondet rrjedhin nga veprimtari kriminale.

2. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse dërgohet te DPPP-jë, një raport i ri, një transfertë në tentativë apo bëhet përmirësim i një raportit të mëparshëm.

PJESA I. INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË

1. **Statusi ligjor i personit:** Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, ent publik, OJF, organizime ligjore, SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuara), kujdestar, degë e shoqërisë së huaj.

2. **Emri, atësia, mbiemri:** për individin shkruhen emri, atësia dhe mbiemri.

3. **Datëlindja/data e regjistrimit (dd.mm.vvvv):** nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 03.04.1978.

4. **Shtetësia:** shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. **Vendlindja:** shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur;

6. **Vendbanimin e përkohshëm (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

7. **Gjinia: a. Mashkull; b. Femër:** shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse individi është mashkull apo femër.

8. **Dokumenti i identifikimit:** a) ☐ letërnjoftim; b) ☐ pasaportë; c) ☐ nr. personal (NID);

Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas llojit të dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

9. **Numri i dokumentit:** këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim, si dhe numri personal.

10. **Autoriteti lëshues:** këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

11. **Emërtimi i subjektit:** këtu shkruhet emri i subjektit.

12. **NUIS/NIPT:** shkruhen numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

13. **Adresa e themelimit:** shkruhet adresa e plotë e zyrës qendrore të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

14. **Adresa e përkohshme (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.

15. **Punësim/lloji i aktivitetit:** jepet përshkrimi i punësimit ose llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

16. **Nëse është PEP:** shënohet një kryq në kutinë përkatëse nëse subjekti është person i ekspozuar politikisht.

PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRË

Në këtë pjesë të raportit jepen të dhënat mbi personat e përfshirë në transaksion.

PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

1. **Numri i transaksioneve:** shkruhet numri i transaksioneve të kryera apo të tentuara.



2. **Numri i llogarisë/ve:** shkruhen numri/at e llogarive të përfshira në aktivitetin e dyshimtë;

3. **Data e kryerjes së transaksionit:** data e transaksionit shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e transaksionit është 5 maj 2008, në raport duhet të shkruhet 05.05.2008.

4. **Monedha:** vihet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit p.sh.: LEK, USD, GBP, EUR etj.

5. **Shuma e transaksionit:** shkruhet shuma në lekë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Në këtë pjesë të raportit subjekti raportues bën një përshkrim të aktivitetit dhe të arsyeve për dyshim. Limiti i karaktereve është vendosur për të

siguruar përditësimin e informacioneve voluminoze që hyjnë në databazë, p.sh.: tabela, figura; materialet mbi këtë limit mund të përcillen të zipuara te pjesa V.)

PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE

Në këtë pjesë të raportit vendosen të zipuara dokumentet që shoqërojnë raportin.

PJESA VI. INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat rreth subjektit raportues, si: emri i subjektit, emri dhe firma e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, emri i personit që bën aprovimin e raportit RAD (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit në formatin (dd.mm.vvvv), si dhe numrin e telefonit/adresën e-mail, si dhe adresën e personit përgjegjës më anë të të cilit autoriteti përgjegjës mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur.

ANEKS II

RAPORTI I TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE (RTPF)

Në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 milion lek

Zgjidhni kutinë e duhur:	
☐ Raport i ri	☐ Përmirëson një raport të mëparshëm ☐ Transaksione të lidhura
☐ Përfshihen më shumë se një individ/shoqëri	
PJESA I. PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION	
SEKSIONI A. PERSONI QË KRYEN TRANSAKSIONIN	
1. Statusi ligjor i personit: a. ☐ Individ; ☐ Person fizik tregtar; ☐ Person juridik;	
d. ☐ Shoqëri Anonime; e. ☐ Ent Publik; f. ☐ OJF; g. ☐ Organizime Ligjore	
h. ☐ SHPK (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) i. ☐ Kujdestar; j. ☐ Dege e shoqërisë së huaj;	
2. a) Emri: _____ b. Atësia: _____ c. Mbiemri: _____	
3. Datëlindja/data e regjistrimit: _____	
4. Shtetësia: a. ☐ Shqiptar ☐ I huaj;	
5. Vendlindja: _____	
6. Vendbanimin e përkohshëm (nëse ka): _____	
7. Gjinia: a. ☐ Mashkull; b. ☐ Femër;	
8. Dokumenti i identifikimit:	
a) ☐ Letërnjoftim; b) ☐ pasaportë; c) ☐ Nr. Personal(NID);	
9. Numri i dokumentit: _____	
10. Autoriteti lëshues: _____	
11. Emërtimi i Subjektit: _____;	
12. NUIS/NIPT: _____;	
13. Adresa e themelimit: _____;	
14. Adresa e përkohshme (nëse ka): _____;	
15. Punësim/lloji i aktivitetit: _____;	
SEKSIONI A. 1-PERSONI I PËRFSHIRË NË KRYERJEN E TRANSAKSIONIT	
PJESA II. PERSONI/AT PËRFTUES	
SEKSIONI B. PERSONI/AT PËRFTUES	
1. Statusi ligjor i personit: a. ☐ Individ; b. ☐ Person fizik tregtar; c. ☐ Person juridik;	
d. ☐ Shoqëri Anonime; e. ☐ Ent Publik; f. ☐ OJF; g. ☐ Organizime Ligjore	
h. ☐ SHPK (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) i. ☐ Kujdestar; j. ☐ Degë e shoqërisë së huaj;	
2. a) Emri: _____ b. Atësia: _____ c. Mbiemri: _____	
3. Datëlindja/data e regjistrimit: _____	
4. Shtetësia: a. ☐ Shqiptar ☐ I huaj;	
5. Vendlindja: _____	
6. Vendbanimi i përkohshëm (nëse ka): _____	
7. Gjinia: a. ☐ Mashkull; b. ☐ Femër;	
8. Dokumenti i identifikimit:	
a) ☐ Letërnjoftim; b) ☐ pasaportë; c) ☐ Nr. Personal(NID);	
9. Numri i dokumentit: _____	
10. Autoriteti lëshues: _____	
11. Emërtimi i Subjektit: _____;	
12. NUIS/NIPT: _____;	
13. Adresa e themelimit: _____;	
14. Adresa e përkohshme (nëse ka): _____;	
15. Punësim/lloji i aktivitetit: _____;	
SEKSIONI B. 1- PERSONI/AT PËRFTUES I PËRFSHIRË	
PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER	
1. Numri i transaksioneve: _____;	
2. Lloji i transaksionit:	
a) ☐ Depozitë Kredi; b) ☐ Tërheqje cash; c) ☐ Derdhje cash; d) ☐ Pagesa Këmbim	
valutor; e) ☐ Shitje/Blerje letrash me vlerë; f) ☐ Shitje/Blerje aksionesh; g) ☐ Pasuri e	
blerë/shitur; h) ☐ Shitje kuotash; i) ☐ Kalim Fondesh; j) ☐ Huadhënie;	
k) ☐ Huamarrje; l) ☐ Dhurim;	
3. Data e kryerjes së transaksionit: _____;	



4. Monedha: Lek ☐ Euro ☐ USD ☐ GBP ☐ JPY ☐ CHF ☐ ☐ D		Sipas një liste
5. Shuma e transaksionit: _____;		
6. Shënim për transaksionin: _____;		
PJESA IV. INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES:		
Emri: _____;	Data e raportimit: ____-____-____;	
Personi përgjegjës: _____;	Tel. _____;	
Firma: _____;	E-mail: _____;	
Aprovuesi: _____;	Adresa: _____;	

INSTRUKSIONET PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË RAPORTIMIT TË TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE

(Për transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 milion lek)

Formulari i raportimit të transaksioneve në para fizike (RTPF), është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Me anë të këtij formulari bëhet raportimi nga subjektet i transaksionit/eve në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 milion lek (ose kundërvlera në një monedhë tjetër).

Bëni një kryq në kutinë/të sipas rastit të raportimit që bëhet (p.sh.: raportim i ri, përmirësim i një raportimi të mëparshëm, nëse ka shumë persona të përfshirë në transaksion ose bëhet fjalë për transaksione të lidhura të kryera brenda afatit të përcaktuar në këtë udhëzim).

1. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse aktiviteti dyshohet se ka të bëjë me pastrim parash apo financim të terrorizmit.

2. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse dërgohet te DPPP-ja një raport i ri apo bëhet përmirësim i një raporti të mëparshëm.

PJESA I. PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION

Seksioni A. Plotësohet në të gjitha rastet

Nëse personi kryen një transaksion në emër të vet, plotësoni seksionin A dhe lëreni seksionin B, bosh.

Nëse një individ kryen një transaksion në emër të tij dhe të personit/ave të tjerë, plotësoni seksionin A me të dhënat e mëposhtme për personin që kryen transaksionin dhe seksionin B për personin në emër të të cilit kryhet transaksioni.

1. **Statusi ligjor i personit:** me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit

individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, ent publik, OJF, organizime ligjore, SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuara), kujdestar, degë e shoqërisë së huaj.

2. **Emri, atësia, mbiemri:** për individin shkruhen emri, atësia dhe mbiemri.

3. **Datëlindja/data e regjistrimit (dd.mm.vvvv):** nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 03.04.1978.

4. **Shtetësia:** shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. **Vendlindja:** shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur;

6. **Vendbanimin e përkohshëm (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

7. **Gjinia: a. Mashkull; b. Femër:** shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse individi është mashkull apo femër.

8. **Dokumenti i identifikimit:** a) ☐ letërnjoftim; b) ☐ pasaportë; c) ☐ nr. personal (NID);

Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas llojit të dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

9. **Numri i dokumentit:** këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim, si dhe numri personal.



10. **Autoriteti lëshues:** këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

11. **Emërtimi i subjektit:** këtu shkruhet emri i subjektit.

12. **NUIS/NIPT:** shkruhen numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

13. **Adresa e themelimit:** shkruhet adresa e plotë e zyrës qendrore të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

14. **Adresa e përkohshme (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.

15. **Punësim/lloji i aktivitetit:** jepet përshkrimi i punësimit ose llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

Seksioni A.1. Personi që kryen transaksionin e përfshirë

Në këtë seksion shtohen të dhënat për personat e tjerë që janë të përfshirë si palë me personin që kryen transaksionin e raportuar.

PJESA II. PERSONI/AT PËRFITUES

Në këtë pjesë subjekti raportues jep të dhëna të plota për përfituesin në rastet kur ai është i ndryshëm nga personi në seksionet A dhe B.

Seksioni B. Personi në emër të të cilit kryhet transaksioni

Ky seksion plotësohet në të gjitha rastet kur personi/at që kryejnë transaksionin/et, janë të ndryshëm nga ata në emër të të cilëve kryhet transaksioni/et. (P.sh. nëse një punonjës i EuroMax bën një depozitim për llogari të shoqërisë, kjo e fundit duhet të identifikohet në seksionin B dhe punonjësi që kryen transaksionin duhet të identifikohet në seksionin A.)

Subjektet duhet të plotësojnë të gjitha të dhënat sipas mënyrës së plotësimit të përshkruar më sipër në seksionin A.

1. **Statusi ligjor i personit:** me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, ent publik, OJF, organizime ligjore, SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), kujdestar, degë e shoqërisë së huaj.

2. **Emri, atësia, mbiemri:** për individin shkruhen emri, atësia dhe mbiemri.

3. **Datëlindja/data e regjistrimit (dd.mm.vvvv):** nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 03.04.1978.

4. **Shtetësia:** shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. **Vendlindja:** shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur;

6. **Vendbanimi i përkohshëm (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

7. **Gjinia: a. Mashkull; b. Femër:** shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse individi është mashkull apo femër.

8. **Dokumenti i identifikimit:** a) ☐ letërnjoftim; b) ☐ pasaportë; c) ☐ nr. personal (NID);

Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas llojit të dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

9. **Numri i dokumentit:** këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim, si dhe numri personal.

10. **Autoriteti lëshues:** këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

11. **Emërtimi i subjektit:** këtu shkruhet emri i subjektit.

12. **NUIS/NIPT:** shkruhen numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

13. **Adresa e themelimit:** shkruhet adresa e plotë e zyrës qendrore të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

14. **Adresa e përkohshme (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.



15. Punësim/lloji i aktivitetit: jepet përshkrimi i punësimit ose llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

Seksioni B.1. Personi/at përfitues

Në këtë seksion shtohen të dhënat për personat që janë përfitues nga transaksioni i raportuar.

PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

1. Numri i transaksioneve: shkruhet numri i transaksioneve të kryera apo të tentuara shuma e transaksionit: shkruhet shuma në para fizike në lek për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën, shuma e agreguar e të cilave e kalon vlerën e 1 milion lek apo kundërvlerën në monedha të huaja. Afati kohor për llogaritjen e transaksioneve të lidhura është 24 orë.

2. Lloji i transaksionit: shënohet me kryq lloji i transaksionit (p.sh. depozitë kredi, tërheqje *cash*, derdhje *cash*, pagesakëmbim valutor etj.);

3. Data e transaksionit: shkruhet data e kryerjes së transaksionit në formatin ditë, muaj, vit (dd.mm.vvvv.) Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. (P.sh. nëse data e transaksionit është 5 prill 2009, në raport duhet të shkruhet 05.04.2009.). Për subjektet të cilat bëjnë dhe regjistrimin e orës së transaksionit shkruhet, gjithashtu, dhe ora.

4. Monedha: bëhet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit (p.sh. lek, USD, GBP, EUR etj.).

5. Shuma e transaksionit: _____;

6. Shënim për transaksionin: në këtë pjesë të raportit subjekti raportues jep shënime lidhur me transaksionin.

PJESA IV. INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat rreth subjektit raportues, si: emri i subjektit, emri dhe firma e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, emri i personit që bën aprovimin e raportit RAD (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit në formatin (dd.mm.vvvv), si dhe numrin e telefonit/adresën e-mail, si dhe adresën e personit përgjegjës më anë të të cilit autoriteti përgjegjës mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur.

UDHËZIM

Nr. 30, datë 28.7.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 29, DATË 31.12.2012, TË MINISTRIT TË FINANCAVE “PËR MËNYRAT DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË PROFESIONEVE TË LIRA JOFINANCIARE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 28, pika 3, germa “a” të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë:

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 29, datë 31.12.2012, të ministrit të Financave, “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare,” bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

1. Në nenin 1, pas shkronjës “... h ...”, shtohet shkronja “... ll ...”.

2. Në nenin 3 bëhen ndryshime dhe shtesat si më poshtë vijon:

- Në pikën 2, në fjalinë e parë, pas togfjalëshit “... fotokopje të noterizuara...” shtohet togfjalëshi “..., ose dokument elektronik që plotëson kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik”.

- Në pikën 2, germa “a” shtohet një nënpikë, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Dokument identifikimi, i njohur me marrëveshje ndërkombëtare, brenda afatit të vlefshmërisë.”.

- Në pikën 3, germa “a”, togfjalëshi “Libreza apo kontratë pune” zëvendësohet me togfjalëshin “Libreza/ kontrata pune, vërtetim pune apo dokument tjetër që provon marrëdhënien e punës.”

